



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 18, datë 04.03.2019**

**PËR**  
**REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DUKAGJINI” KOSOVË**  
**PËR LICENCIMIN E DEGËS SË SAJ PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË**  
**SIGURIMIT NË KLASAT E JO-JETËS NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, mbështetur në nenin 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe pas shqyrtimit të relacionit të Zyrës së Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve,

**K O N S T A T O I   S E :**

Shoqëria “Dukagjini” Kosovë, ka paraqitur në AMF kërkesën dhe dokumentacionin fillestar, për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit në klasat e Jo-Jetës nëpërmjet degës së saj në Shqipëri, me shkresën e shoqërisë pa nr. prot., datë 30.10.2017, protokolluar në AMF me nr. 3080 prot., datë 06.11.2017.

Procesi i licencimit të degës së shoqërisë të huaj të sigurimit, bazohet në pikën 1, shkronja “b” e nenit 10 dhe në nenin 42, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në nenet 31, 34, 35 dhe 38 të këtij ligji, të cilat janë të zbatueshme për vendimmarrjen e Autoritetit në lidhje me licencimin e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj.

Autoriteti me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr. 118, datë 27.04.2018, ngriti grupin e punës për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria e sigurimit “Dukagjini”.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria, ka pasur mangësi dhe për këtë arsye ka pasur disa komunikime shkresore me shoqërinë në vazhdim, si dhe është zhvilluar takim në AMF.

Shoqëria “Dukagjini” sh.a. me shkresën e saj nr. 007/8, datë 27.02.2018 (protokolluar në AMF me nr. 432/1, datë 28.02.2018), datë 09.07.2018 (protokolluar në AMF me nr. 2049/1, datë 09.07.2018), nr. 54 prot, datë 31.10.2018 (protokolluar në AMF me nr.3564/1 prot., datë 22.11.2018), nr. 57 prot, datë 16.11.2018 (protokolluar në AMF nr. 3564/2 prot., datë 23.11.2018) depozitoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, duke mos plotësuar kërkesat e parashikuara në nenin 42, pika 2, shkronja “h” dhe shkronja “i” që lidhen me kapitalin minimal dhe fondin e garancisë.

Në datë 20.07.2018 në AMF u zhvillua takimi midis Grupit të Punës së ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit të degës së shoqërisë “Dukagjini” dhe përfaqësuesve të shoqërisë “Dukagjini” Kosovë, Kryeshefit Ekzekutiv, shefit të financës, të cilët u angazhuan në plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore dhe veçanërisht ato që lidhen me kapitalin minimal dhe fondin e garancisë.

Bazuar në kërkesat e nenit 42, pika 2 shkronja “h” dhe shkronja “i”, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, rezulton se shoqëria “Dukagjini” Kosovë, e cila ka paraqitur kërkesë në AMF për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit në klasat e Jo-Jetës nëpërmjet degës së saj në Shqipëri, nuk ka plotësuar kërkesat që lidhen me kapitalin minimal fillestar (neni 13) dhe fondin e garancisë, i cili sipas përcaktimeve të nenit 81 të Ligjit nr. 52/2014, nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë.

Gjithashtu shoqëria “Dukagjini” Kosovë, nuk ka respektuar afatet ligjore të depozitimit të plotë të informacionit të kërkuar (1 mujor), lidhur me fazën e shqyrtimit të dokumentacionit sipas përcaktimeve të pikës 4, neni 32 i Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në nenin 32 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”,

## **V E N D O S I:**

- 1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Dukagjini” Kosovë për licencimin e degës së saj, për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat e Jo-Jetës në territorin e Republikës së Shqipërisë.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**